



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E përpiluar me datën 15.11.2019 në Lipjan ndërmjet

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson drejtorit të Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Adem Duriqi në njërin anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit “Gafurr Jashari B.I”- (NPSH Doni Term) nga Drenasi të cilën e përfaqëson z. Gafurr Jashari (në anën tjetër) në tekstin e mëtejshëm kontraktuesi.

Titullin e kontratës: “Ndrimi i kalldasë në QMF-Shalë dhe ndrimi i pompës kryesore të ngrohjes qendrore në QKMF-Lipjan” me numër identifikues 613 019 127 536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: “Ndrimi i kalldasë në QMF-Shalë dhe ndrimi i pompës kryesore të ngrohjes qendrore në QKMF-Lipjan”, të gjitha të specifikuara të përshkrimi i çmimeve

1.2 Kontrata hynë në fuqi 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës gjegjësisht me 18.11.2019 dhe do të përfundojë më 01.12.2019 apo 14 kalendarike.

1.4 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë Objekti i QMF-së Shalë dhe objekti i QKMF-së Lipjan

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e punëve shprehur në shifra është **4,327.00 €** shprehur me shkrim katërmijë e treqind e njëzetë e shtatë / Euro/ zero /cent/.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bresës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit dhe që inkorporojnë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në material. Kontraktuesi do të garantojë se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet dhe kryejnë funksionin pa pengesa. Kontraktuesi është i obliguar që pas kryerjes së punëve të bëjë sigurimin mbi kualitetin e punëve prej 10% të vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 12 muaj.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë materialet e furnizuara dhe shërbimet e të kryera, në mënyrë që të përcaktojë nëse shërbimet janë kryer sipas paramasës në kontratë. Menaxher i kontratës është Idriz Kozhani

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep diku kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Gafurr Jashari
Pozita:	Drejtoi prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	10.11.2019
Vula:		Vula:	

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali
-----	------------	--------	-------	-------	--------

1	Demolimi I kalldas egzistuese dhe bartja deri ne Deponi Demolimi I mureve per futjene kalldas me pelet, si dhe murosja suvatimi dhe kthimi ne aktualjen e me parshme	Komplet	1	250.00	250.00
2	Largimi I deres te dhoma e kaldas, si dhe montimi pasi qe te vendoset kaldaja e re	m²	15	1.00	15.00
3	furnizimi dhe montimi I kalldas me pelet 65KW	Cope	1	2,550.00	2,550.00
4	Furnizimi dhe montimi i brinerit me transporte te peletit 65 kW	Cope	1	60.00	60.00
5	Furnizimi dhe montimi I rezervuarit te peletit 180 l	Cope	1	10.00	10.00
6	Furnizimi dhe montimi I enes expanduese 80 l	Cope	1	100.00	100.00
7	Furnizimi dhe montimi I pompes qarkulluese TIP GHN 32 -80 F	Cope	1	250.00	250.00
8	Furnizimi dhe montimi I valvulave sferike me holander fi 5/4	Cope	3	25.00	75.00
9	Furnizimi dhe montimi me Gyp CU fi 35	m'	7	12.00	84.00
10	Furnizimi dhe montimi me lakesa CU fi 35	Cope	15	5.00	75.00
11	Furnizimi dhe montimi MS fi 35	Cope	8	3.50	28.00
12	Furnizimi dhe montimi MB fi 35	Cope	8	4.00	32.00
13	Furnizimi dhe montimi me Holander fi 5/4	Cope	2	12.00	24.00
14	Furnizimi dhe montimi me unaze vazhduese mesing fi 5/4	Cope	2	5.00	10.00
15	Furnizimi dhe montimi me kthese nipell fi 5/4	Cope	2	5.00	10.00
16	Furnizimi dhe montimi me termomanometer	Cope	1	16.00	16.00
17	Furnizimi dhe montimi me TE CU fi 35 - 18 - 35	Cope	4	9.00	36.00
18	Furnizimi dhe montimi me fi 18	Cope	4	3.00	12.00
19	Furnizimi dhe montimi me qynga fi 100	m'	3	30.00	90.00
20	Furnizimi dhe montimi me brryla per qynge	Cope	3	30.00	90.00
21	Shpuarja e murit per kyqje ne oxhak	Cope	2	10.00	20.00
22	Ajrosja automatike	Cope	3	10.00	30.00
23	Furnizimi dhe montimi me valvola per mbushje dhe zbrazje	Cope	2	10.00	20.00
24	Furnizimi dhe montimi me valvola siguruese 3 bar	Cope	1	20.00	20.00
25	Furnizimi dhe montimi me pjese percjellese te valvules sferike me holander DN 25 per enen expanduese	Cope	1	20.00	20.00
26	Mbushhja e rrjetit testimi dhe leshuarja ne pune e Kaldase	Komplet	1	100.00	100.00
27	Furnizimi dhe montimi me llamarine per mbulojen e anexit depos se peletit, te llogaritet bulona, silikon si dhe pjeset percjellese	m²	20	15.00	300.00

RIKAPITULLIM	4,327.00€
--------------	------------------